
NEKROLOGJI

**KRISTAQ PRIFTI, PROFESORI DHE AKADEMIKU
ME KONTRIBUT TË VEÇANTË NË STUDIMIN
E HISTORISË KOMBËTARE SHQIPTARE**

Më datë 9 dhjetor 2017 u nda nga jeta akademik Kristaq Prifti, një historian dhe turkolog i njohur jo vetëm në Shqipëri në Kosovë dhe në trojet e tjera shqiptare, por edhe më gjerë. K.Prifti lindi në Berat më 21 dhjetor 1932. Në këtë qytet kreu arsimimin fillestar e të mesëm, kurse studimet e larta i realizoi dhe i përfundoi me rezultate shumë të mira në Fakultetin e Historisë në Institutin Pedagogjik në Moskë (1951-1955). Pas kthimit në atdhe ai punoi si pedagog i Historisë së përgjithshme dhe të Shqipërisë në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

Profilizimi si pedagog dhe studiues i prof. K.Priftit, u orientua kryesisht në periudhën e Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në vitet 1960-1975, ai, njëherësh, u ngarkua edhe me detyra të rëndësishme, fillimisht, nga viti 1960, ushtroi detyrën e përgjegjës të Katedrës së Historisë, dy vjet më vonë detyrën e zëvendësdekanit dhe në vitet 1969-1975 do të ishte në postin e dekanit të Fakultetit. Në gjysmën e dytë të viteve 70 punoi edhe në Arkivin Qendror të Shtetit dhe në detyra të tjera administrative. Ndërkohë, nga viti 1972 deri në vitin 1980, u angazhua edhe me mbajtjen e ligjëratave në kursin e magistraturës në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin 1982, prof. K.Prifti u bë pjesë e profesoratit shkencor të Institutit të Historisë, të Akademisë së Shkencave. Ai fillimisht riorganizoi dhe për 10 vjet drejtoi Sektorin e Historisë Bashkëkohore të Kosovës të krijuar në vitin 1979, kurse në vitet 1991-1993, ishte drejtor i Institutit.

Njohës i mirë i historisë jo vetëm për periudhën e Rilindjes, por edhe historisë së shek.XX, madje jo vetëm të historisë brenda kufijve të shtetit

shqiptar, por edhe të historisë së Kosovës dhe të trevave të tjera shqiptare, të shkëputura në vitin 1913, prof. K.Prifti, krahas veprimtarisë studimore e botuese, dha një kontribut të vyer edhe si konsulent i diplomacisë shqiptare për çështjen e Kosovës.

Puna intensive dhe me një skrupulozitet të spikatur do të konkretizohej ndërkohë me studime e botime të ndryshme, me disa vëllime monografike, që rroknin tema të tilla si Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878-1881), Lidhja Shqiptare e Pejës (1899-1900), roli i shqiptarëve në Revolucionin Xhonturk, lëvizja kulturore - politike në Shqipëri (1908-1910), Kongresi i Manastirit (1908), Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe Qeveria e Përkohshme e Ismail Qemalit, probleme të historisë së Kosovës në shek. XX, etj.

Prof. K.Prifti, ka qenë promotori i botimit të parë solid me studime e dokumente për historinë e Kosovës, të titulluar “E vërteta për Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, botuar nga Akademia e Shkencave në vitin 1990. Me këmbënguljen e tij vëllimi u përkthye dhe u botua në vitin 1992 edhe në gjuhën angleze. Ai gjithashtu ishte në krye të punës për organizimin me sukses të Simpoziumit Ndërkombëtar “Çështja e Kosovës – një problem historik dhe aktual” organizuar nga Instituti i Historisë – Prishtinë dhe Instituti i Historisë –Tiranë, që u zhvillua në Tiranë më 15-16 prill 1993, me 59 pjesëmarrës nga 13 vende të botës, aktet e të cilit u botuan në vitin 1996 në shqip dhe në anglisht.

Vitet e fundit pas një pune voluminoze dhjetjavëçare, profesori finalizoi edhe monografinë e tij madhore “Popullsia e Kosovës 1831-1912”, e cila pa dritën e botimit në vitin 2014 dhe në projektet e veta synonte të bënte të njëjtën gjë edhe për viset e ish vilajetit të Manastirit.

Për veprimtarinë e tij shkencore, prof. K.Prifti është vlerësuar nga autoritetet e larta të vendit, duke u dekoruar me Urdhrin “Flamuri i Kuq i Punës” i Klasit të Parë dhe me “Çmimin e Republikës” të Shkallës së Dytë.

Instituti Amerikan i Biografive e ka përfshirë prof. dr. Kristaq Priftin në veprën “Pesë mijë personalitete të Botës” (Botimi i gjashtë, 1998) dhe i ka dhënë atij titullin “Njeriu i vitit 1997”, të cilin ky Institut e konsideron si një titull prestigjioz.

Po kështu, Qendra Ndërkombëtare e Biografive në Kembrixh e ka përfshirë prof. dr. Kristaq Priftin në Fjalorin Biografik Ndërkombëtar, botimi 27, i publikuar në vitin 1999, me titullin e ndryshuar “Njerëz të

shquar të shekullit XX” dhe i ka dhënë titullin “Njeriu i viteve 1998-1999” duke i akorduar edhe “Medaljen e Nderit”.

Jo vetëm familja e miqtë, por edhe gjithë komuniteti shkencor e përjetoj me dhimbje humbjen e profesorit dhe akademikut të nderuar, Kristaq Prifti.

Marenglen VERLI